



**REPUB LIKA E KOSOVËS**  
**Komuna Drenas/Gllogoc**  
**Zyra e Personelit**  
**01Nr. 111- 53049 dt. 06.09 /2019**

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllogoc/Drenas, shpallë:

**KONKURS PUBLIK**  
**Për pozitën : Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave**

|                                                     |                                                                         |
|-----------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emri i institucionit rekrutues:</b>              | Komuna Drenas/Gllogoc                                                   |
| <b>Nr. i references:</b>                            | RN00005574                                                              |
| <b>Pozita e punës:</b>                              | Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave BF/140                   |
| <b>Institucioni:</b>                                | Komuna Drenas/Gllogoc                                                   |
| <b>Divizioni/njësia:</b>                            | Drejtoria për Buxhet dhe Financa                                        |
| <b>Lloji i pozitës:</b>                             | I Karrierës                                                             |
| <b>Tipi i akt emërimit të punës:</b>                | Orar të Plotë                                                           |
| <b>Pozita e punës së mbikëqyrësit:</b>              | Drejtori                                                                |
| <b>Kategoria Funksionale –Grada</b>                 | Drejtues 2 , Koeficienti 9.5                                            |
| <b>Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:</b> | Po                                                                      |
| <b>Procedura e Aplikimit:</b>                       | I Jashtëm                                                               |
| <b>Numri i kërkuar:</b>                             | 1 punëtor/e                                                             |
| <b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>                      | I përhershëm                                                            |
| <b>Kategoritë funksionale , vendndodhja :</b>       | Drejtues 2, Koeficienti 9.5, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Drenas. |

**Përshkrimi detyrave të punës:**

1. Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa (ZKF) është përgjegjës për veprimtarin e rregullt dhe të ligjshme financare të organizatës buxhetore;
2. Të siguroi që të gjitha transaksionet të regjistrohen në regjistrin e kontabilitetit;
3. Të siguroi që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga njësit buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim nga sistemi i thesarit;
4. Mbikëqyrë të gjitha aspektet e raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore;
5. Ushtrimi i funksionit të dhënë zyrtarit në përputhshmeri të plotë me Ligjin mbi Financat dhe rregullat e kontrollës së brendshme financiare të jetë në përputhshmëri me ligjin;
6. Raporton për punën dhe planin e punës te Drejtori dhe Kryetari i Komunës, zbaton ligjet mbi financat Publike;
7. Regjistrimi i Buxhetit në Sistem BDMS ;
8. Kryen edhe punë të tjera të deleguara nga Drejtori për Buxhet dhe Financa;

**Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:**

Diplomë universitare - Fakulteti Ekonomik – Drejtimi Banka, Financa, Kontabilitet apo Menaxhmet dhe Financa, 4 vite përvojë pune profesionale;

Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe financave, shkathtësi të nivelit lartë në menaxhim, caktim të objektivave dhe planifikim;

Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit, shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;

Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Acces );

**Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:**

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, çertifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kritereve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **06/09/2019** deri më **20/09/2019**, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes web faqës dhe shpalljes në hyrje të Komunës.



Udhëheqëse e Personelit

*H. Shabani*  
Anumshahe Shabani